

Në bazë të nenit 28 paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18) dhe nenit 5 paragrafi (1) të Ligjit për kontroll të ndihmës shtetërore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 145/10), Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në seancën e mbajtur më 21.10.2020, solli

MENDIM

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës shqyrtoi Thirrjen Publike të dorëzuar për digjitalizimin e shërbimeve të vetëqeverisjes lokale nga Fondi i Inovacioneve dhe Zhvillimit Teknologjik nga aspekti nëse i njëjti parasheh dhënien e ndihmës shtetërore në pajtim me Ligjin për kontroll të ndihmës shtetërore dhe Rregulloren për kushtet dhe procedurën për dhënien e ndihmës de minimis (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 141/11).

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, gjatë shqyrtimit të Thirrjes Publike për digjitalizimin e shërbimeve të vetëqeverisjes lokale, **konstatoi se ndarja e mjeteve përmes kësaj Thirrjeje publike nuk paraqet ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 5 paragrafi (1) të Ligjit për kontroll të ndihmës shtetërore**, për faktin se nuk ka përfitim ekonomik për marrësin dhe përmes kësaj ndarjeje nuk ndikohet mbi konkurrencën dhe tregtinë.

Në Thirrjen publike për digjitalizimin e shërbimeve të qeverisjes lokale, thuhet se Fondi për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik në bashkëpunim me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), shpall thirrje për financimin e projekteve për ofrimin e zgjidhjeve/mjeteve digjitale që do të futen në punët e përditshme të pesë komunave në Republikën e Maqedonisë së Veriut: **Qendër Zhupë, Bogovinë, Shën Nikollë, Prilep dhe Kumanovë**. Qëllimi i thirrjes është digjitalizimi i përshpejtuar i shërbimeve të vetëqeverisjes lokale përmes zhvillimit të mjeteve/zgjidhjeve digjitale me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në komunat e përzgjedhura, duke lehtësuar respektimin e masave për parandalimin e përhapjes së virusit dhe përshpejtimin e rimëkëmbjes ekonomike nga pasojat e shkaktuara nga pandemia e COVID-19.

Në kuadër të thirrjes publike “Digjitalizimi i shërbimeve të vetëqeverisjes lokale”, çdo aplikant ka mundësinë të paraqesë një propozim zgjidhje për e- platformë. Për financimin e projekteve sipas kësaj thirrjeje është siguruar buxhet i përgjithshëm prej 75.000 (shtatëdhjetë e pesë mijë) dollarë amerikanë në kundërvlerë në denarë. Fondi siguron financim deri në 100% (njëqind për qind) të buxhetit të përgjithshëm për projektin, në shumën maksimale prej 75.000 (shtatëdhjetë e pesë) mijë dollarë amerikanë në kundërvlerë në denarë për projekt, duke përfshirë shpenzimet e mbikëqyrjes në vlerë prej 10% nga buxheti i përgjithshëm operativ i projektit. Konkretisht, Thirrja publike u dedikohet ndërmarrjeve që mund të ofrojnë një zgjidhje inovative dhe/ose teknologjike të avancuar të vetme ose në bashkëpunim me një

institucion që ushtron arsimin e lartë, gjegjësisht një veprimtari kërkimore-shkencore, një ndërmarrjeje tjetër dhe/ose shoqatë. Duke pasur parasysh se bëhet fjalë për një shërbim që do të paguhet nga ndërmarrjet që do të aplikojnë në Konkursin Publik për zhvillimin e projekteve për ofrimin e zgjidhjeve/veglave digjitale që do të vendosen në punën e përditshme të pesë komunave në Republikën e Maqedonisë së Veriut. , Komisioni vlerëson se nuk ka asnjë përparësi ekonomike për përfituesin në kuptim të nenit 5 të Ligjit për Kontroll të Ndhmës Shtetërore. Gjegjësisht, bëhet fjalë për qarkullimin e një shërbimi i cili pas ekzekutimit të tij do të paguhet në mënyrë përkatëse.

Në bazë të nenit 6 paragrafi (2) të Ligjit për kontroll të ndihmës shtetërore, përfitues i ndihmës shtetërore është ndërmarrja që merr pjesë në shitjen e mallrave dhe/ose shërbimeve, dhe shfrytëzon një nga format e ndihmës shtetërore. Njësitë e vetëqeverisjes lokale si shfrytëzues përfundimtarë nuk paraqesin përfitues të ndihmës shtetërore në pajtim me nenin 6 paragrafi (2) të Ligjit për kontroll të ndihmës shtetërore.

Sipas Thirrjes Publike, përfituesi i mjeteve financiare duhet mjetet/zgjidhjet që paraqesin rezultatin e zbatimit të projektit për të cilin janë ndarë mjetet financiare dhe/ose të drejtat e shfrytëzimit të pronësisë intelektuale që eventualisht do të ishin rezultat i projektit, , të jenë në dispozicion plotësisht dhe pa pagesë, pa kufizime për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut pa ndonjë kompensim ose pagesë të mjeteve shtesë, përveç atyre që paguhet në bazë të Marrëveshjes për ndarjen e mjeteve financiare.

Sipas asaj që u tha më lartë, ndarja e mjeteve përmes Thirrjes Publike për digjitalizimin e shërbimeve të vetëqeverisjes lokale nuk paraqet ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 5 paragrafi (1) të Ligjit për kontroll të ndihmës shtetërore.

KRYETAR

I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Prof. Dr. Владимир Наумовски